

VENDIM
Nr. 279, datë 29.4.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 658, DATË 8.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGËS SË
ELBASANIT (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE E TIRANËS)”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 658, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve ndryshon nga “150 563 038.8 (njëqind e pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekë” në “152 588 338.8 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekë”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 152 588 338.8 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekësh përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera prej 150 563 038.8 (njëqind e pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekësh përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Shpronësimet”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar;

b) vlera prej 2 025 300 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e treqind) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

3. Në pikën 5, vlera e shpenzimeve procedurale, prej 211 500 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, zëvendësohet me vlerën prej 261 500 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh, e cila përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

4. Tabelave bashkëlidhur vendimit në fuqi shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA E PRONARËVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 658, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT "ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE E TIRANËS), I NDRYSHUAR

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Sipërf. e përgj. truall m ²	Sipërf. e prekur truall m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Lloji i pasurisë	Vlera e përgjithshme	Adresa	Shënime
1	Besim Valteri	8190	11/1423	163.72	60	33755	2,025,300.00	truall	2,025,300.00	Torre Drinit Njësia 4	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale								2,025,300		